

URDHËR
Nr. 1198, datë 24.8.2021

**PËR DELEGIMIN E AUTORITETIT TË NËNSHKRIMIT TË KËRKESAVE DHE
TË DOKUMENTACIONIT SHOQËRUES PËR PAJISJEN ME “CERTIFIKATË
SIGURIE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të shkronjës “F”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘sekret shtetëror’”, të ndryshuar; të vendimit nr. 188, datë 4.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e autoritetit të nënshkrimit të kërkesave dhe të dokumentacionit shoqërues për Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, për pajisjen e personelit të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, strukturave vartëse të tyre, si dhe personelit kontraktor, me “Certifikatë sigurie” për njohjen me informacion të klasifikuar “sekret shtetëror” dhe të NATO-s, te zëvendësministri i Mbrojtjes, znj. Dallëndyshe Bici.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ndjekin zbatimin e këtij urdhri: Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtoria e Zbulimit në SHP, komandantët e forcave dhe njësive, komandantët e reparteve dhe institucioneve të varësisë së drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi